

PHI LAN THR OPY

edicioni 6

hapësirë e dedikuar

për FILANTROPINË

#philanthropy

— kontakt :   



©PARTNERËT SHQIPËRI PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

TIRANË, SHQIPËRI

Ky publikim u përgatit me mbështetjen financiare të Fondit Rockefeller Brothers. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e Partnerëve Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Fondit Rockefeller Brothers.

PHI LAN THR OPY

hapësirë e dedikuar
për FILANTROPINË

Në këtë edicion



5

Rreth revistës

7

Të dhëna rreth
aktivitetit filantropik

janar - qershor 2023

17

Rrathë Dhurues 2023

23

Smile.al

Shpallet thirrja për
aplikime nga OJF-të

26

**Intervista me
përfaqësues të
nismave filantropike
në vend**

Mark Kosmo

34

**Fushata në ndihmë të
personave në nevojë**

37

Fondacionet Komunitare

40

**Zhvillime nga rrjeti
"Wings"**

Mirë se vini në edicionin e gjashtë të revistës Philanthropy!

Në këtë edicion, ju do të njiheni me nismat e ndërmarra në fushën e **aktivitetit filantropik** gjatë periudhës janar – qershor 2023.

Në qershor të këtij viti u organizua ankandi i katërt i dhurimit live, "**Rrathë Dhurues 2023**". Ankandi bëri bashkë individë, përfaqësues të sektorit të biznesit, komunitetit të donatorëve, shoqërisë civile etj., të cilët ofruan mbështetje financiare, materiale, dhe konsulencë falas për zbatimin e tre nismave të prezantuara. Shuma totale e mbledhur prej 2,511,879 Lekë e tejkaloi objektivin e vendosur prej 900,000 Lekë në total, duke konfirmuar sërish ndjeshmërinë e lartë qytetare dhe solidaritetin ndaj komuniteteve në nevojë.

Smile.al e para dhe e vetmja platformë crowdfunding në Shqipëri ka shpallur thirrjen për projekt propozime, e cila targeton organizatat jofitimprurëse në të gjithë vendin. Thirrja është e hapur deri më datë 30 shtator 2023. Gjatë kësaj periudhe tre iniciativa të reja komunitare u shpallën në platformë dhe në këtë edicion do të njiheni me to.

R
r
a
t
h
ë
D
h
u
r
u
e
s



Në këtë publikim, kemi kënaqësinë t'ju prezantojmë me një nga nismat më të fundit të ndërrmarra nga Fondacioni Global Shqiptar (GAF) "**Korçarët Ndhmojmë Korçarët**". Z. Mark Kosmo, themelues dhe kryetar i bordit të GAF, gjatë intervistës së tij ndan detajet e programit, i cili do të mbështesë nismat e organizatave që kanë seli në Korçë dhe komunitetin e këtij qyteti.

Gjatë këtij gjashtë mujori të parë të vitit është vënë re trendi rritës i nismave të individëve që mbështesin **fushata në ndihmë të personave në nevojë**. Në vijim do të njiheni me disa prej tyre.

Fondacionet Komunitare luajnë një rol të rëndësishëm në mobilizimin e komunitetit për zbatimin e iniciativave të ndryshme për të përmirësuar jetën e qytetarëve. Gjatë këtyre muajve, Partnerët Shqipëri ka vijuar asistencën ndaj dy organizatave dhe një grupi informal duke u fokusuar tek procesi i hartimit të një plani mobilizimi mbështetësish, planifikimit strategjik dhe matjes së impaktit të nismave komunitare. Përmes një videoje promocionale do të njiheni me punën e tyre për fuqizimin e komuniteteve që u shërbejnë.

Rrjeti "**WINGS**" është një platformë globale për zhvillimin e filantropisë ku anëtarët dhe grupet e interesit bashkëpunojnë për adresimin e sfidave globale dhe sjelljen e ndryshimeve të qëndrueshme.

Gjatë muajit maj, rrjeti "WINGS" prezantoi "Planin Strategjik 2023-2027". Qëllimi i tij është forcimi i ekosistemit të filantropisë në nivel global, për të ndikuar në ndryshimin e praktikave filantropike dhe përmirësimin e veprimtarisë së vetë rrjetit.

"**European Community Foundation Initiative - ECFI**" ka publikuar raportin "Fondacionet Komunitare në Evropë – Situata për vitin 2022".

Nëse keni komente mbi artikujt e këtij edicioni apo jeni të interesuar për të qenë në edicionin e radhës, ju lutem shkruani tek erexhepi@partnersalbania.org

Lexim të këndshëm!

T Ë D H Ë N A R R E T H A K T I V I T E T I T F I L A N T R O P I K J A N A R - Q E R S H O R 2 0 2 3


Të dhënat e mëposhtme pasqyrojnë aktivitetin filantropik në Shqipëri gjatë gjashtë muorit të parë të vitit 2023, bazuar në monitorimin ditor të mediave, përfshi ato sociale, si dhe nga raportimet dhe publikimet e institucioneve publike dhe jo-publike. Raporti analizon sektorët dhe çështjet kryesore që kanë mbështetur, natyrën dhe vlerën e dhurimeve, mbulimin gjeografik si dhe natyrën e dhuruesve dhe përfituesve.

Nëpërmjet këtij monitorimi, Partnerët Shqipëri synon të rrisë vetëdijen publike mbi aktivitetin filantropik dhe të informojë të gjithë aktorët e përfshirë dhe të interesuar mbi impaktin dhe vlerën sociale të tij.


Gjatë gjashtë muorit të parë të vitit 2023, u regjistrua një numër prej **48,265 dhurimesh** me një vlerë dhurimi prej **1,001,768 Lekë (9,567,121 Euro)**.

Krahasuar me të dhënat e gjashtë muorit të parë të vitit të kaluar, vërejmë një rritje në numrin e fushatave të dhurimit, me një shtim prej 65% të rasteve. Numri i dhuruesve është dyfishuar, ndërsa shuma totale e dhurimit është trefishuar.

Numri i dhurimeve sipas natyrës



Vlera sipas natyrës së dhurimit në Lekë




Tre format kryesore të mbledhjes së dhurimeve janë përmes **Eventeve**,
Fushatave dhe në formë të **Drejtëpërdrejtë**.

Dhurimet sipas formës

70 dhurime në formë të Drejtëpërdrejtë

135 dhurime përmes Eventeve

48,060 dhurime përmes Fushatave



3 DHURUESIT KRYESOR

sipas numrit të dhurimeve

- #1 Banka Credins (27)
- #2 OTP Bank Albania (14)
- #3 Union Bank (12)

3 DHURIMET KRYESOR

sipas vlerës së dhurimeve

#1 Bankers Petroleum 728,000,000 Lekë

Bankers Petroleum Albania po fokusohet tek **mbrojtja e mjedisit** dhe trajtimi i mbetjeve të naftës.

#2 Individë 18,432,920 Lekë

Fushata për ngritjen e fondeve "**Të shpëtojmë jetën e Stefani Stambolliu!**", në mbështetje të një vajze 13 vjeçare, e cila vuan nga një sëmundje terminale.

#3 Individë 15,253,164 Lekë

Fushata për ngritjen e fondeve "**Të shpëtojmë jetën e Jasminës!**", e cila ndodhet në gjendje shëndetësore të rënduar.

3 DHURUESIT MË TË MËDHENJ

sipas vlerës së dhurimeve

#1 Bankers Petroleum 728,000,000 Lekë

#2 Banka Amerikane e Investimeve 10,830,0000 Lekë

#3 Banka Credins 623,840 Lekë

Fushata për ngritjen e fondeve

167
Thirrje për Dhurime

19
Fushata përmes
platformave
Crowdfunding

89
Fushata përmes Medias Sociale
& Platformave Crowdfunding

12
Megafushata


6
Fushata përmes
platformës Facebook për
Impaktin Social*

Evente

65
Evente live


*Platforma e dedikuar e Facebook për ngritje fondesh për kauza sociale.

Numri i dhuruesve sipas natyrës*




*Në kuadër të kësaj analize, dhuruesit llogariten vetëm një herë, pavarësisht nga numri i dhurimeve të kryera gjatë procesit të monitorimit.

Vlera sipas natyrës së dhuruesit




Përfituesit Përfundimtar



- Fëmijë dhe të rinj
- Publik i gjerë
- Individë/Familje
- Tjetër
- Më shumë se një kategori



- Në vështirësi ekonomike, shëndetësore dhe sociale (38.41%)
- Publik i gjerë (26.81%)
- Komunitet fetar (10.14%)
- Zonë specifike (4.35%)




- Të moshuar (45.65%)
- Në vështirësi ekonomike, shëndetësore dhe sociale (21.74%)
- Gra dhe Fëmijë në risk (21.74%)



- Në vështirësi ekonomike, shëndetësore dhe sociale (64.29%)
- Fëmijë dhe të rinj (18.57%)
- Të talentuar (13.33%)
- Zonë Specifike (3.81%)

Shpërndarja Gjeografike e Përfituesve

Gjatë vitit 2022, **82.5%** e dhurimeve u shpërndanë në Shqipëri, ndërsa pjesa tjetër jashtë vendit siç është paraqitur grafikisht më poshtë:



*Vlorë, Fier, Kukës, Dibër, Lushnje, Berat, Krujë, Pogradec, Malësi e Madhe, Gjirokastër, Përmet, Tropojë.


E panjohur



Shtetas të huaj





Kosovë




Shpërndarja Gjeografike e Dhuruesve

92.3% e dhurimeve janë kryer nga dhurues nga diaspora, ndërsa pjesa e mbetur nga dhurues nga Shqipëria dhe shtetas të huaj.



* Mat, Shkodër.



Diaspora 92.3%

E panjohur 1.68%


Shtetas
të huaj 0.11%

Gjatë gjashtë mujorit të parë të 2023, vitit 2022, **5** fushat kryesore të dhurimeve janë si më poshtë:


Ndërkohë kategoria "Tjetër" përfshinë dhurimet e kryera për: *Ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit* (0.09%), *Edukimin* (0.08%), *Artin dhe Kulturën* (0.08%), *Të Drejtat e njeriut/Angazhimin qytetar* (0.06%), *Zhvillimin ekonomik* (0.05%), *Infrastrukturën publike* (0.05%), *Mirëqenien e kafshëve* (0.04%), *Sportin* (0.04%), *Zhvillimin Komunitar* (0.02%) etj.

Qëllimi i dhurimit

- Shëndetësi
- Dhurime sezonale
- Zbutja e varfërisë
- Përgjigje ndaj fatkeqësisë natyrore
- Mbështetje e grupeve të marginalizuara
- Tjetër



Kanalet e dhurimit





Në gjashtë mujorin e parë të vitit 2023, janë gjurmuar 414 artikuj në median e shkruar, audiovizive dhe atë sociale, të cilat mbulojnë fushatat dhe iniciativat dhuruese. Platforma më e zakonshme për këtë promovim ka qenë media sociale, Facebook, që është një nga kanalet e preferuara për shpërndarjen e informacionit rreth rasteve të dhurimit.

Në të njëjtë kohë, media vizive ka prodhuar një numër të pasur emisionesh dhe reportazhesh të fokusuara në çështje të cilat kanë patur nevojë për mbështetje. Faqet zyrtare të internetit të institucioneve publike kanë vazhduar të jenë një burim i rëndësishëm për promovimin dhe raportimin e zhvillimeve në fushën e dhurimit.

Dhurim i drejtpërdrejtë - Dhurimi që kryhet direkt nga dhuruesi tek përfituesi

Fushata për ngritjen e fondeve - Mbledhje e fondeve që ndodh gjatë një periudhe të caktuar kohe për një kauzë të caktuar sociale

Evente – Është një ngjarje që organizohet në kuadër të mbledhjes së fondeve për një kauzë të caktuar

Zbutja e Varfërisë - Dhurimet që janë kryer për zbutjen e varfërisë për individë apo familje që jetojnë në vështirësi ekonomike apo të prekur nga fatkeqësitë e mëparshme natyrore

Dhurime Sezonalë – Dhurime që kryen gjatë sezonit të festave

Publik i Gjerë - Përfituesit e dhurimeve apo iniciativave që kanë një impakt në publikun e gjerë.

Miks – Dhurime të cilat kombinohen nga më shumë se një kategori / qytet

NVM - Ndërmarrje të vogla dhe të mesme

Platforma Crowdfunding (Individë apo familje) – dhurimet që kanalizohen përmes platformave online crowdfunding, të krijuara nga individë apo familje

Platforma Crowdfunding (OJF) – dhurimet që kanalizohen përmes platformave online crowdfunding, të krijuara nga OJF-të

Institucione Private - Biznese

Tjetër - Cdo kategori tjetër që nuk i përket kategorive të mëparshme.

20

R R A T H Ë D H U R U E S

1 3 Q E R S H O R 2 0 2 3

Në qershor 2023 u organizua event i katërt "Rrathë Dhurues".

"Rrathë Dhurues" është një event i dhurimeve live, i cili u jep individëve mundësinë të bashkohen rreth një qëllimi filantropik për të mbështetur iniciativa komunitare. Stimulimi i dhurimeve individuale dhe korporative për mbështetjen e nismave lokale të OJF-ve që synojnë një ndryshim social dhe një transformim pozitiv e të qëndrueshëm të komunitetit dhe mjedisit është qëllimi thelbësor i eventit.



#RrathëDhurues
Shqipëri

RRATHË DHUR



Suksesi i eventit “Rrathë Dhurues” i tejkaloi pritshmëritë, duke demonstruar fuqinë e bashkimit dhe ndjeshmërinë kolektive, duke lënë tek të gjithë të pranishmit një kujtim që do të mbetet gjatë. Eventu përforcoi besimin se duke punuar së bashku mund të adresojmë çështje sociale dhe të sjellim ndryshime pozitive në shoqëri. Sërish, edhe këtë vit shuma totale e mbledhur prej **2,511,879** Lekë e tejkaloi disa herë objektivin e vendosur prej 900,000 Lekë në total, duke rikonfirmuar ndjenjën e lartë të solidaritetit qytetar ndaj komuniteteve në nevojë.

Kontributet e mbledhura përmes eventin dhe që ende vijojnë do të mbështesin iniciativat e mëposhtme:

UES 2023



Shërbim i specializuar për 25 fëmijë më aftësi ndryshe

Fëmijët me aftësi ndryshe të zonës së Bathores, ndeshen me një sërë problematikash, si: aksesit i pamjaftueshëm në programet e identifikimit dhe ndërhyrjeve të hershme, shërbimeve mbështetëse në komunitet, mungesën e mjediseve argëtuese dhe zhvilluese për ta etj. Nëpërmjet kësaj nisme komunitare synohet të ofrohen shërbime terapeutike për 25 fëmijë me aftësi ndryshe të grupmoshës 6-14 vjeç, të këtij komuniteti. Në qendrën "Dita e Re" fëmijët do të angazhohen me aktivitete të përshtatshme sipas nevojave për të zhvilluar aftësitë e tyre për tu integruar së bashku me fëmijët tipikë. Nisma do të ndikojë drejtpërdrejtë edhe tek nënat, të cilat do të mund të socializohen me njëra tjetrën, të ndajnë eksperiencën, të eksplorojnë mundësi punësimi apo të kenë më shumë kohë të lirë për veten e tyre. Organizata zbatuese e iniciativës është Global Care Albania.



Të shijojmë natyrën

Kjo është një nismë e fokusuar drejt turizmit cilësor dhe të shtuar në Parkun Kombëtar Shebenik-Jabllanicë, duke kontribuar në një mjedis të pastër dhe atraktiv për turistët vendas dhe të huaj. Parku Shebenik - Jabllanicë i shpallur Park Kombëtar, çdo vit pret rreth 60,000 turistë vendas dhe të huaj, falë vlerave të larta ekoturistike. Brenda tij gjenden mbi 14 liqene akullnajore me bukuri madhështore, pyje, kullota, toka bujqësore, shkëmbore, dhe troje. Por, problemet mjedisore mbeten të shumta. Ndërhyrja fillon me zbatimin e një fushate të dedikuar ndërgjegjësimi, vendosjen se tabelave informuese pranë destinacione turistike si dhe vendosjen e koshave për hedhjen e mbeturinave, të kompostierave të drurit për transformimin e mbeturinave në pleh organik, e stolave e tavolinave të cilat do të shërbejnë si vendpushimi për turistët. Përfshirja e komunitetit lokal në këtë nismë është një nga synimet kryesore duke angazhuar të rinj dhe të reja si dhe institucione vendore publike të zonës. Organizata zbatuese e iniciativës është SOEK-In 'Qendra Rinore Librazhd'.



Rikonceptimi i lulishtes "Marigo Posio"

Lulishtja "Marigo Posio", në bulevardin "Ismail Qemali" të qytetit të Vlorës është një hapësirë e painvestuar ku kryesisht moshë e tretë, shpenzon kohën e lirë duke improvizuar "lojëra tavoline", dominoje dhe shahu. Zona përreth lulishtes popullohet nga bare, restorante dhe apartamente dhe ka potencialin për t'u shndërruar në një hapësirë rekreative që i shërben të gjithë komunitetit të cilët do të bashkëjetojnë në harmoni të plotë. Krijimi i një hapësire të gjelbër, çlodhëse dhe argëtuese e do t'i shërbejë rreth 60-100 të moshuarve, të kalojnë kohën e lirë në mënyrë më cilësore. Së bashku me të, do të ndërtohet edhe një kënd lojrash për fëmijë që do të kontribuojë në vlerësimin e figurës së "gijshit", ndërtimin e solidaritetit mes brezave dhe rritjen e kohezionit social. Organizata zbatuese e iniciativës është CELIM Shqipëri.

Shërbim i specializuar për 25 fëmijë më aftësi ndryshe



Nëse dëshironi të kontribuoni dhe ju në këtë nismë, mund ta bëni duke kontaktuar organizatën zbatuese ose përmes llogarisë bankare:

FOND.GLOBAL CARE ALBANIA
Banka Kombëtare Tregtare
AL8620511210748389CLTJCFEURA
421748389CLTJCFEURA9
Swift Code: NCBAALTX

Të shijojmë natyrën



Nëse dëshironi të kontribuoni dhe ju në këtë nismë, mund ta bëni duke kontaktuar organizatën zbatuese ose përmes llogarisë bankare:

SOEK-In 'Qendra Rinore Librazhd'
OTP BANK Albania
Nr. Llogarisë: 902425123002748890
Swift Code CRBAALTRXXX

Rikonceptimi i lulishtes "Marigo Posio"



Nëse dëshironi të kontribuoni dhe ju në këtë nismë, mund ta bëni duke kontaktuar organizatën zbatuese ose përmes llogarisë bankare:

CELIM Shqipëri
Banka Kombëtare Tregtare
Nr.llogarise (ALL) 410774792CLTJCLALLQF
Swift Code: NCBAALTX



smile.al




27

S M I L E . A L

W W W . S M I L E . A L

Platforma Smile.al ofron një mundësi të veçantë për mbledhjen e fondeve online, në mbështetje të nismave komunitare në fushat e shëndetit, solidaritetit, trashëgimisë kulturore, mjedisit, sipërmarrjes sociale dhe inovative, edukimit e trajnimit, dhe aktivitetet sportive.

The header features the title 'THIRRJE E HAPUR PËR PROJEKT PROPOZIME' in a bold, black, sans-serif font, centered on the page. The text is arranged in three lines. On either side of the text, there are horizontal bars: a solid red bar on the left and a red bar followed by a black bar on the right.

THIRRJE E HAPUR PËR PROJEKT PROPOZIME

Në platformë është shpallur **thirrja për projekt propozime** e cila do të mbështesë nisma komunitare të propozuara nga organizatat jofitimprurëse. Thirrja do të jetë e hapur deri më **30 Shtator 2023**.

Ju ftojmë të njiheni me tre iniciativat më të fundit të publikuara në platformë.

3 INICIATIVAT E REJA



Ndihmë financiare për tërmetin në Turqi

Caritasi Shqiptar ka organizuar një iniciativë për të ndihmuar familjet e prekura nga tërmeti në Turqi. Ata po bëjnë thirrje për kontributet e shqiptarëve, duke i inkurajuar të dhurojnë direkt në platformën "Smile". Fondet do t'u dërgohen Caritas Internationalis për të mbështetur familjet dhe fëmijët që kanë humbur banesat dhe për të siguruar strehim, ushqim dhe ndihmë mjekësore emergjente. Në këtë kohë të vështirë, të gjithë jemi të ftuar të solidarizohemi dhe të japim një ndihmë jetësore atyre që kanë nevojë për mbështetjen tonë. Për më shumë rreth nismës klikoni

[këtu](#)



OriginAL: Një udhëtim për të zbuluar rrënjët

Diaspora shqiptare është një komunitet i madh dhe të rinjtë shqiptarë që jetojnë jashtë vendlindjes po largohen nga rrënjët e tyre, kultura dhe gjuha shqipe. Për të parandaluar humbjen e identitetit, programi OriginAL u ofron të rinjve shqiptarë nga diaspora mundësinë për të eksploruar vendlindjen dhe rrënjët e tyre. Dhurimi juaj do të ndihmojë mbi 100 të rinj të përjetojnë një eksperiencë jetësore në Shqipëri dhe Kosovë dhe të ndërtojnë lidhje të fortë me diasporën. Për më shumë rreth nismës klikoni

[këtu](#)



Mbështet fëmijët jetim "Qëndisje me Ëndrra"

Ky projekt ka si synim kryesor t'u ofrojë këtyre fëmijëve një mundësi më shumë për të mësuar një profesion të bukur siç është arti i të qëndësorit, duke rritur aftësitë e tyre për një të ardhme më të mirë por edhe për një promovim të artit të qëndëstarisë. Projekti ofron një trajnim 2 mujor të fëmijëve jetimë nga artizanë profesionistë për realizimin e disa veprave me tematika të ndryshme në teknikën e qëndisjes me dorë. Le të kontribuojmë të gjithë së bashku në Smile.al për fëmijët jetim duke i dhënë një mundësi më shumë të ardhmes së tyre për të ruajtur traditat dhe kulturën tonë artizanale. Për më shumë rreth nismës klikoni

[këtu](#)

I N T E R V I S T A
M E P Ë R F A Q Ë S U E S
T Ë N I S M A V E
F I L A N T R O P I K E N Ë
V E N D



S O L I D A R I T E T I

I

D I A S P O R Ë S

Mark Kosmo



Themelues dhe Kryetar Bordi i Fondacionit Global Shqiptar

Fondacioni Global Shqiptar (GAF) ka si qëllim të mobilizojë burimet e diasporës shqiptare për të ndihmuar zhvillimin ekonomik dhe social të rajonit të Ballkanit Perëndimor. Fondacioni synon të ndryshojë qëllimin e financimit të diasporës shqiptare duke ofruar një mekanizëm institucional për dhurime të qëndrueshme në vendin e origjinës. Përmes bashkëpunimit me diasporën shqiptare, GAF-i synon të kthejë një pjesë të pasurisë së shqiptarëve jashtë vendit në rajon, duke kontribuar në përparimin dhe përmbushjen e nevojave të shoqërisë në fusha si ndihma për tërmetet dhe pandemia, rinia, arsimi dhe kujdesi shëndetësor. Nisma më e fundit e ndërmarrë nga GAF-i është **“Korçarët Ndhimojmë Korçarët”**. Më poshtë do të keni mundësi të njiheni me detaje nga kjo iniciativë përmes një interviste me themeluesin dhe kryetarin e bordit të Fondacionit Global Shqiptar, Z. Mark Kosmo.

Ju lutem, mund të na tregoni më shumë rreth kësaj nisme, arsytet dhe motivet e saj?

Programi “Korçarët Ndhimojmë Korçarët” do të menaxhohet nga GAF-i dhe do të financohet fillimisht nga Dr. Yvonne Naum nga qyteti i Siatëllit, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ky program është krijuar në nderim të prindërve të saj, Rafail Naum Riza dhe Theodora Stavre Naum, të cilët u rritën në Korçë midis viteve 1901 - 1929. Ata u martuan në vitin 1929 dhe emigruan në Nju Jork, ku krijuan familjen dhe jetuan jetën e tyre.

Dr. Naum do të jetë në krye të programit duke filluar nga viti 2023, e cila do të vërë në dispozicion fondin prej 22,500 Dollarë gjatë tre viteve të para. Gjithashtu, në testamentin e saj pas vdekjes, ajo do të kontribuojë për programin duke lënë 50% të pasurisë saj në mbështetje të tij. Qëllimi ynë është të mbledhim 90,000 Dollarë për aktivitetet e planifikuara për vitin 2023 dhe 2024, duke filluar nga 90-vjetori i lindjes së Dr. Naum më 5 korrik.



Dr. Yvonne Naum

A Program of **GAF** GLOBAL ALBANIANS
FOR EDUCATION

Korçarët
Ndhimojmë Korçarët






Aktivitetet ndër vite

#Fondacioni Global Shqiptar



GAF GLOBAL ALBANIAN FOUNDATION

By providing a platform for Albanian youth, we empower them to become ambassadors for their heritage, instilling a sense of pride, responsibility, and commitment to making a positive impact in both their diaspora communities and their countries of origin. This connection can be life-changing and can inspire participants to become more involved in their community and advocate for their culture.



Cili është grupi juaj i synuar, fushat dhe ndikimi i ndërhyrjeve?

Qëllimi i programit “Korçarët Ndhimojmë Korçarët” është të ndihmojë financimin e aktiviteteve të organizatave jofitimprurëse me qendër në qytetin e Korçës. Ne do të fillojmë me një program pilot këtë vjeshtë dhe tre projektet tona të para do të mbështesin:

- Dorcas Albania (DA): Ndhimë për fëmijët në nevojë në shkollën “Naim Frashëri”.
- Fondacioni Misioni Emanuel (EMF): Ndhimë për fëmijët Romë në tre qendrat ditore për fëmijë.
- Instituti për Zhvillimin e Fëmijëve Korçë (KIDC): Ndhimë për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Çfarë ndikimi është arritur deri më tani nga iniciativa?

Programi është në fazat e para të planifikimit dhe mendojmë që në vjeshtë të fillojë zbatimin e tij. Dëshirojmë të marrim kohën e duhur për të kryer një punë të mirë duke vlerësuar të gjitha aspektet e tij. Hapi ynë i parë do të jetë krijimi i një Bordi Këshillues i përbërë prej 7-10 personash, të cilët jetojnë në Korçë, atdhetarë korçarë që jetojnë në diasporë dhe njerëz të njohur të sektorit jofitimprurës në Shqipëri. Ky Bord Këshillues do të ndihmojë në identifikimin e partnerëve të mundshëm në Korçë, krijimin e udhëzimeve operationale dhe në mbledhjen e fondeve.



Cilat janë planet tuaja për të ardhmen?

Ne planifikojmë që programi “Korçarët Ndhimojmë Korçarët” të bëhet plotësisht funksional në vitin 2024 pas kryerjes së programimit pilot gjatë vitit 2023. Në vitin 2023, ne planifikojmë të mbështesim 3 organizata, me shuma financimi prej 8,000 Dollarë secila, por ky numër mund të rritet nëse kemi rezultat nga mbledhja e fondeve nga publiku. Pas kësaj, ne planifikojmë të zhvillojmë gradualisht kapacitetet tona për të aksesuar më shumë dhurime dhe për të ofruar më shumë mbështetje gjatë 2-3 viteve të ardhshme. Vizioni ynë është ndërtimi i një programi që do të mbështetet nga mijëra shqiptarë që identifikohen si “Korçarë”. Ne besojmë se mund të bëhet shumë për të patur zhvillime në Korçë përmes ndihmës së diasporës së madhe shqiptare nga Korça dhe shpresojmë që ky program të jetë një katalizator që të tjerët të dhurojnë. Programi “Korçarët Ndhimojmë Korçarët” synon të sigurojë burimet dhe mbështetjen e nevojshme për të fuqizuar brezin e ardhshëm të Korçës dhe për të sjellë një ndryshim të qëndrueshëm. Ne jemi entuziast të shohim se çfarë mund të arrijmë së bashku në vitet e ardhshme.

F o n d a c i o n i G l o b a l S h q i p t a r



Si mund të dhurojnë njerëzit në programin “Korçarët Ndhimojmë Korçarët”?

Çdokush mund të dhurojë në fajen e internetit të GAF ose në mbledhjen e fondeve në Facebook. Nëse keni ndonjë pyetje, mund të kontaktoni në Mark.Kosmo@GlobalAlbanians.org.

DHURO

***Korçarët
Ndhimojmë
Korçarët***

#Original



#Shkollat në Shkodër

F U S H A T A

N Ë N D I H M Ë T Ë

P E R S O N A V E N Ë

N E V O J Ë

Fushata

Disa nga fushatat e ngritura gjatë
muajve janar - qershor 2023.

SHPRESË PËR BOTËN



#1

Grupi "Buzëqeshja Jote", i cili përbëhet nga 4 anëtarë që jetojnë në qytetin e Korçës, ka dhënë ndihmën e tyre në krijimin e një shtëpie të ngrohtë për familjen e zotit Nezir nga Panariti i Korçës, e cila po jetonte në kushte shumë të vështira banimi.

BUZËQESHJA JOTE



#2

Fondacioni "Shpresë për Botën" mbledhi 6,000 Dollarë për të rikonstruktuar këndin e lojërave në jetimorën e foshnjave në Shkodër. Ky kënd ishte hapësira e tyre e vetme për të kaluar një pjesë të ditëve me diell jashtë mureve të jetimores. Ata kontribuan në rikthimin e një hapësire të përshtatshme dhe të sigurt për këta fëmijë.

#3

Shoqata Kombëtare Shqiptare e Njerëzve që nuk Dëgjojnë mbledhi fonde për të dërguar 4 anëtarë të Federatës Botërore të Rinisë së Njerëzve që nuk Dëgjojnë (WFDYS) në Federatën Botërore të Njerëzve që nuk Dëgjojnë (WFD).

Help send four Deaf Albanian Leaders
to the World Federation of the Deaf!



Aldi



Françeska



Ernisa



Suad



#4

Organizata “Code for Albania” punon me teknologjinë, inovacionin, mendimin kritik, sipërmarrjen, për të ndryshuar jetën e shumë të rinjve shqiptarë. “Code for Albania” celi kampin e pestë veror në Korçë, ku mbledhën rreth 150 të rinj nga gjithë Shqipëria.

#5

Organizata “World Vision Albania” në bashkëpunim me dyqanet OKAËDI hapën thirrjen për dhurimin e veshjeve të përdorura për fëmijët në kushte të vështira. Prindërit dhe fëmijët bashkohen për të dhuruar veshje të cilat fëmijët e tyre nuk i përdorin më. “Jepi Veshjes një jetë të dytë!” nuk është vetëm një thirrje për dhurim veshjesh, por është një ftesë për të krijuar ndryshime pozitive në jetët e atyre që kanë më shumë nevojë.

JEPI VESHJES NJË JETË TË DYTË



Partnerët Shqipëri ka vijuar asistencën për dy organizata dhe një grup informal për ti fuqizuar në drejtim të ushtrimit të veprimtarisë si fondacione komunitare. Mbështetja u fokusua tek procesi i hartimit të planit të mobilizimit të mbështetësve, zbatimit të ndërhyrjeve në komunitet dhe matjes së impaktit të këtyre nismave. Përmes asistencës së dhënë, tashmë secili aktor është gati të fillojë zbatimin e tyre.

ASISTENCË TEKNIKE PËR *grupet e targetuara*



PUBLIKIME NË MEDIAN SOCIALE

Duke ndërtuar bazat për krijimin e Fondacioneve Komunitare

Në maj të 2023, PSH publikoi videon “**Duke ndërtuar bazat për krijimin e Fondacioneve Komunitare në Shqipëri!**” e cila prezanton tre iniciatorët e parë dhe punën e tyre në këtë drejtim.



FONDACIONET KOMUNITARE

European Community Foundation Initiative - ECFI" ka publikuar raportin "Fondacionet Komunitare në Evropë – situata për vitin 2022". Raporti ofron një pasqyrë lidhur me themelimin dhe gjendjen aktuale të fondacioneve komuninate në Evropë. Sipas tij, në total janë 851 fondacione komunitare në 22 shtete dhe 32 organizata mbështetëse për të nxitur zhvillimin e tyre. Raporti nxjerr në pah diversitetin që ekziston brenda Evropës, në lidhje me kontekstin, por edhe me formën dhe funksionimin e fondacioneve komunitare. Partnerët Shqipëri listohet në raport si një ndër organizatat mbështetëse për krijimin e fondacioneve komunitare në nivel kombëtar.



Z H V I L L I M E T N G A R R J E T I W I N G S

Rrjeti WINGS është një platformë globale për zhvillimin e filantropisë ku anëtarët dhe grupet e interesit bashkëpunojnë për adresimin e sfidave globale dhe sjelljen e ndryshimeve të qendrueshme.

R R J E T I W I N G S

Gjatë muajit maj, rrjeti "WINGS" prezantoi "Planin Strategjik 2023-2027". Qëllimi i tij është forcimi i ekosistemit të filantropisë në nivel global, për të ndikuar në ndryshimin e normave dhe praktikave të sektorit filantropik dhe përmirësimin e veprimtarisë së vetë rrjetit. Tre janë prioritetet strategjike që do të udhëheqin punën e rrjetit "WINGS" gjatë periudhës katër vjeçare:

1

Prioriteti kryesor i planit strategjik është ngritja e rrjetit dhe forcimi i ekosistemeve mbështetëse të filantropisë (PSE). Qëllimi i WINGS është të forcojë dhe zgjerojë këto ekosisteme në mënyrë të qëndrueshme, duke diversifikuar anëtarësimin global.

2

WINGS gjithashtu synon të krijoj një mjedis të favorshëm për lulëzimin e filantropisë duke ndikuar në normat dhe praktikat e sektorit për transformim.

3

Transformimi i vetë rrjetit WINGS është prioriteti tretë i planit strategjik. Për të nxitur transformimin në mbarë sektorin e filantropisë në mënyrë efektive, WINGS angazhohet për të përmirësuar kulturën organizative dhe llogaridhënien e saj.



Rruga e Elbasanit, ndërtesa Park Gate, kati 10,
App. 71 / 73, PO BOX 2418/1
1010 Tirana, Albania